Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0030

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullorës së Punës në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Avni Murtezi B.I" kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2024" me numër të prokurimit 623-23-13234-1-2-1, të Komunës së Rahovecit në cilësi të autoritetit kontraktues (AK), më 13/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Avni Murtezi B.I.", me nr. 2024/30, e datës 05/01/2024, kurse vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2024" me nr. të prokurimit: "623-23-13234-1-2-1", anulohet, lënda kthehet në ri-vlerësim

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.

3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 27/11/2023, Komuna e Rahovecit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2024". Ndërsa me datën 28/12/2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "N.T.P Harris".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës: 124,640.00 €.

Me 02/01/2024, OE "Avni Murtezi B.I." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03/01/2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05/01/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Avni Murtezi B.I." me nr. 30/24 lidhur me aktivitetin "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2024 " me nr. të prokurimit: "623-23-13234-1-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigja e AK ne ndaj kërkesës për rishqyrtim: "Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ku kemi cekur: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT): Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e kontratës, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit; Dëshmia 3: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj.) Vëmendje!. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit; Sqarimet janë si në vijim: Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi për këto pajisje: Kamion kiper, me peshë bartëse deri 5m3 – në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje keni paraqitur: Kamion për bartjen e Kontinerëve me 2 dyer, tabela Nr. 01-219-ZE, me peshë bartëse mbi 14m3 (14191); Kamion, me peshë bartëse deri 3m3 – në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje keni paraqitur: Kamion me 2 dyer, tabela Nr. 01-941-LC, me peshë bartëse mbi 8m3 (8940); Kamion me vinç, me peshë bartëse deri 8m3 – në ofertën e juaj të

prezantuar për këtë pajisje keni paraqitur: Kamion me vinç me 2 dyer, tabela Nr. 01-861-UB, me peshë bartëse mbi 10m3 (10600); Nuk e keni plotësuar këtë kriter sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së. Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi. Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92."

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues"Avni Murtezi B.I." janë parashtruar si në vijim:

*Pretendimi ankimor: "*Kronologjia e aktivitetit të prokurimit "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës se Rahovecit për vitin 2023/2024" ZPP dhe komisioni i vlerësimit në Komunën e Rahovecit gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk kanë vepruar sipas dispozitave të LPP dhe kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit. Për më tepër qasja e tyre ka rezultuar me diskriminim të OE N.T.SH. "Berveniku" i cili i ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar gjithsejtë 7 operatorë ekonomik. Nga procesi i vlerësimit ishte rekomanduar për kontratë N.P.T "Haris" me çmim prej 121,360.00 € me çmim me të lartë nga të gjithë OE që kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe me një diferencë me të lartë në çmimi prej 13,612 euro nga N.T.SH. "Berveniku" si OE i përgjegjshëm. Arsyeja e eliminimit për OE N.T.Sh. "Berveniku" është shumë joprofesionale dhe e kundërligjshme. N.T.Sh. "Berveniku" është eliminuar për arsye se pesha bartëse e kamionëve me të cilët ka ofertuar është më e lartë së sa pesha bartëse e kamionëve që është kërkuar në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës se Rahovecit për vitin 2023/2024". Arsyeja e eliminimit është joprofesionale për faktin se nëse kamionët me të cilët ka ofertuar N.T.Sh. "Berveniku" kanë kapacitet më të madh të bartjes se peletit, kjo nuk e dëmton asgjë AK, përkundrazi furnizimi mund të kryhet me shpejtë. Bazuar në këtë shihet qartë se për ZPP nuk ka qenë qëllim që të kontrata të nënshkruhet me OE të përgjegjshëm, por të përzgjidhet në çfarëdo forme OE i favorizuar N.P.T "Haris" me çmimin më të lartë nga të gjithë ofertuesit dhe si OE që është i themeluar në Komunën e Rahovecit. Në tekstin në vijim është arsyetimi i ZPP. Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, për OE N.T.Sh. "Berveniku" thuhet citim "Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT): Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e kontratës, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit; Dëshmia 3: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj.). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit; Sqarimet janë si në vijim: Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi për këto pajisje: Kamion kiper, me peshë bartëse deri 5m3-në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje keni paraqitur: Kamion për bartjen e Kontinerëve me 2 dyer, tabela Nr. 01-219-ZE, me peshë bartëse mbi 14m3 (14191); Kamion, me peshë bartëse deri 3m3 në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje keni paraqitur: Kamion me 2 dyer, tabela Nr. 01-941-LC, me peshë bartëse mbi 8m3 (8940); Kamion me vinç, me peshë bartëse deri 8m3 në ofertën e juaj të prezantuar për këtë

pajisje keni paraqitur: Kamion me vinç me 2 dyer, tabela Nr. 01-861-UB, me peshë bartëse mbi 10m3 (10600); Nuk e keni plotësuar këtë kriter sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së". Arsyetimet e dhëna nga ZPP dhe komisioni i vlerësimit në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE N.T.SH. "Berveniku" tregon se OE N.T.Sh. "Berveniku" është eliminuar nga konkurrenca për arsye se kapaciteti i kamionëve me të cilët OE N.T.Sh. "Berveniku" ka ofertuar është më i lartë së sa kapaciteti i kërkuar në dosjen e tenderit për të tre llojet e kërkuara të kamionëve dhe së njëri nga kamionët më të cilin ka ofertuar OE N.T.Sh. "Berveniku" nuk është kiper. Ky arsyetim është në kundërshtim me LPP dhe kërkesat në dosjen e tenderit, është kriter diskriminues, kufizon konkurrencën dhe dëmton buxhetin e AK duke ia dhënë kontratën OE me çmim më të lartë nga të gjithë pjesëmarrësit dhe me çmimi me të lartë se N.T.Sh "Berveniku" për 13,612 euro. Fillimisht pesha bartëse për kamion e përcaktuara në dosjen e tenderit është imagjinare dhe në kundërshtim me kategorizimin e automjeteve në bazë të peshës bartëse sipas kornizës ligjore në fuqi. Bazuar në Ligjin Nr. 02/L-70 për sigurinë në komunikacionin rrugor, automjetet transportuese kategorizohen në dy kategori: - automjetet transportuese me masë deri 3.5 ton; dhe - automjetet transportuese me masë mbi 3.5 ton. Pra pesha bartëse e përcaktuar në dosjen e tenderit për kamion nuk ekziston dhe nuk ka kamion që peshohet me metër kub, por njësia matëse për mjetet e transportit të mallrave është ton apo kg. Këtë kriter nuk e ka plotësuar as OE N.P.T "Haris" të cilit i është dhënë kontrata sepse kamion që peshohen me metër kub nuk ekzistojnë. Megjithatë, kriteret e peshës bartëse për kamion të përcaktuara në dosjen e tenderit janë kërkesa minimale të përcaktuara nga AK KK Rahovec dhe N.T.Sh "Berveniku" i ka plotësuar kriteret e peshës dhe i ka tejkaluar ato. Sipas LPP dhe legjislacionit sekondar OE nuk mund të eliminohet nga konkurrenca nëse kapaciteti i ofruar është më i lartë së kërkesat minimale të përcaktuara në dosjen e tenderit. Një shembull i thjesht dhe i krahasueshëm me rastin e peshës bartëse të kamionëve është qarkullimi financiar i kërkuar në dosje, a është e arsyeshme të eliminohet OE që ka qarkullim më shumë se sa shuma e kërkuar në dosjen e tenderit. Rëndësia e këtij kriteri është të vlerësohen kapacitetet teknike për realizimin e furnizimit dhe kapaciteti më i madh i peshës bartëse që është ofruar nga N.T.Sh. "Berveniku" tregon mundësin e tij për realizim më të shpejtë dhe efikas të furnizimit me pelet. Pra, OE N.T.Sh. "Berveniku" i ka ofruar kamionët që i plotësojnë kërkesat e AK dhe po ashtu njëri nga kamionët është kiper, prandaj bashkë me këtë kërkesë për rishqyrtim do të ofrojmë edhe fotot të kamionëve. Sipas LPP dhe legjislacionit sekondar AK gjatë përcaktimit të kritereve të përzgjedhjes duhet të përcaktojnë kritere që janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë. Për më tepër kriteret që kanë të bëjnë me kualifikimet dhe kapacitetet e tenderuesit janë kriteret minimale për kualifikim dhe nëse OE ofrojnë dëshmi se i plotësojnë dhe i tejkalojnë kriteret e vendosura, kjo i siguron përparësi qëllimit të kontratës. P.sh derisa është kërkuar që pesha bartëse e kamionëve të jetë në nivelin minimal të përcaktuar në dosjen e tenderit, ofertimi i OE me kamion me peshë bartëse të kapacitetit më të madh, siguron AK për kryerje të furnizimit në mënyrë me efikase dhe më ekonomike. Psh. N.T.Sh "Berveniku" për peshën bartës që është kërkuar 5m3 ka ofruar kamion më peshë bartëse 14m3 që do të thotë me kamionin me të cilin ka ofertuar njëherësh mund ta furnizoj KK Rahovecit më pothuajse 3 fishin e sasisë krahasuar më peshën bartëse 5m3 të kërkuar në dosjen e tenderit. Praktikisht kjo do të rezultojë me shpenzime më të ulëta të operimit për OE në njërën anë dhe realizim më të shpejtë të furnizimit për AK në anën tjetër. Situatë e ngjashme dhe e favorshme është edhe për dy kamionët tjerë që janë kërkuar në dosjen e tenderit. Kamion, me peshë bartëse deri 3m3 është kërkuar në dosjen e tenderit, ndërsa N.T.SH "Berveniku" ka ofertuar me kamion me peshë bartëse mbi 8m3 (8940) si dhe kamion me vinç, me peshë bartëse deri 8m3 është kërkuar në dosjen e tenderit, ndërsa N.T.SH "Berveniku" ka

ofertuar me kamion me peshë bartëse mbi 10m3 (10600). Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe komisioni i vlerësimit duke shkelur mbi parimin e trajtimit të barabarte dhe qëllimin e përdorimit ekonomik, efikas dhe efektiv të parasë publike, nuk i ka respektuar dispozitat përkatëse të LPP dhe legjislacionit sekondar, nuk janë brengosur për dëmin financiar që ja ka shkaktuar buxhetit të Komunës së Rahovecit dhe na ka eliminuar neve nga konkurrenca. Bazuar në dispozitat e legjislacionit për prokurim kriteret minimale për kualifikim – kapacitetet teknike në këtë rast janë kritere më të cilat tenderuesit vlerësohen se është në gjendje për ta përmbushur kontratën në fjalë dhe është shumë pak relevante apo aspak nëse kamionët kanë më shumë kapacitet të bartjes. Kjo pason drejtpërdrejt nga neni 56 i LPP-së. Ofertimi me kamion më peshë bartëse më të madhe se sa pesha e kërkuar në dosjen e tenderit nuk përben devijim as material e as të ndonjë lloji tjetër, përkundrazi është përparësi dhe është në pajtueshmëri të plotë me kërkesat minimale për kualifikim të përcaktuara në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës se Rahovecit për vitin 2023/2024". Nëse gjatë përcaktimit të kritereve të përzgjedhjes në dosjen e tenderit, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit qëllimisht në nder dijen e tij e ka bërë formulimin e kritereve për kapacitetet teknike në mënyrë të tillë për të favorizuar OE që tashmë i është dhënë kontrata, atëherë ne konsiderojmë se kjo është shkelje e rëndë e bërë nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, sipas nenit 97, paragrafit 1, pikës d, të Rregullores 001/2023 për Prokurim Publik, e cila thotë "Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë, vendosjen e kritereve apo dëshmive jo në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabarte të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njësisë së kërkesës". Pra, vendosja e kriterit për kapacitetin teknik – përcaktimi i peshës minimale bartës për tre kamionët si në dosjen e tenderit dhe eliminimi nga konkurrenca i OE që kanë ofertuar me kamion me peshë bartëse më të lartë, duke e dëmtuar buxhetin e AK K.K Rahovec me 13,612 euro dhe duke ja dhënë kontratën OE N.P.T "Haris" ofertuesit më të shtrenjtë, përbënë bazë të mjaftueshme për shkeljen e parimit të trajtimit të barabartë/diskriminimit, konkurrencës dhe efikasitetit dhe ekonomicitetit. Kjo për faktin, së çfarë rëndësie ka pesha e kamionit në furnizimin me pelet, kur dihet së me rëndësi është liverimi i peletit, ndërsa dëmet materiale nga ky kriter i panevojshëm i shkaktojnë buxhetit të Komunës së Rahovecit shpenzime shtesë prej 13,612 euro më tepër. Në përcaktimin e këtij kriteri për kapacitetet teknike AK ka shkelur dispozitat e LPP-së që kërkojnë nga AK që gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, t'i kushtohet rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe të formulohen kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashtojnë OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptoj në lidhje me vlerën e parashikuar të kontratës, dhe përdorim të drejtë të fondeve publike. Se kriteri i kapacitetin teknik – pesha minimale bartës e kamionëve është përshtatur për një OE e dëshmon fakti së edhe vitin e kaluar kontrata i është dhënë OE N.P.T "Haris" dhe këtë vit është vazhduar furnizimi nga i njëjti OE edhe pse çmimet e peletit kanë pësuar rënie krahasuar me vitin paraprak. OE N.P.T "Haris" është OE i themeluar apo me seli në Komunën e Rahovecit, prandaj ne kërkojmë nga OSHP-ja që të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për ta mbrojtur zbatimin e LPP dhe parimeve themelore të prokurimit më qëllim të shfrytëzimit ekonomik, efikas dhe efektiv të parasë publike. Po ashtu, arsyetimi i dhënë për eliminimin e OE N.T.Sh. "Berveniku" bie ndesh me nenin 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave të LPP, i cili thotë "një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse OE i përmbush kërkesat minimale për kualifikim të përcaktuara nga AK në dosjen e tenderit dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së". Përveç së më sipër, gjatë vlerësimit të ofertave për aktivitetin e

prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës se Rahovecit për vitin 2023/2024” janë bërë edhe shkeljet në vijim: Është shkelur neni 1 Qëllimi i LPP-së i cili përcakton qartë që “Autoriteti kontraktues do t’i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Gjithashtu qëllimi i nenit 1 të LPP-së është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Është shkelur neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, i LPP sepse komisioni i vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i kanë trajtuar njëtrajtshëm OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës se Rahovecit për vitin 2023/2024”. Pra OE N.T.Sh. “Berveniku” është diskriminuar duke mos e shpallur fitues edhe pse i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Është shkelur neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti – në bazë të të cilit AK duhet të dëshmojë se procesi i prokurimit siguron vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues, ndërsa kontrata i është dhënë OE që është me çmim më të lartë nga të gjithë operatoret ekonomik pjesëmarrës, ndërsa krahasuar me OE N.T.Sh. “Berveniku” është më i shtrenjtë 13,612 euro. Është shkelur neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, sipas të cilit të gjitha kontratat publike do të jepen përmes vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave minimale të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara dhe në përputhshmëri me kriteret për dhënien e kontratës. Është shkelur neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve sepse ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara në dosje dhe dëshmive të ofruara nga OE N.T.SH. “Beverniku” por është eliminuar pa arsye dhe kështu është kufizuar konkurrenca dhe është favorizuar OE i preferuar. Është shkelur neni 60 kriteret për dhënien e kontratës sepse edhe pse në dosjen e tenderit është përcaktuar kriter për dhënien e kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, ndërsa kontrata i është dhënë OE N.P.T “Haris” i cili ka çmimin më të lartë. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (VI) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”, kurse OE N.P.T “Haris” i rekomanduar për kontratë është me çmim më të lartë nga të gjithë ofertuesit. Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë".

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Avni Murtezi B.I” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin Neni 1, 6, 7, 56, 59 dhe 60 të LPP-së. Kërkojmë nga OSHP që të trajtojë pretendimet ankimore bazuar në LPP dhe legjislacionin sekondar dhe që të nxjerr: Vendim që të Aprovohet, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim OE N.T.Sh. “Berveniku” Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante

lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17.01.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 30/2024, ndërsa me datë 28.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 30/2024 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa rekomandon qe aktiviteti i prokurimit të anulohet ne tërësi".

Lidhur me pretendimet e OE "Avni Murtezi B.I" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/30 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë: *"*Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me eliminimin e tij për shkak të mos përmbushjes së Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa 3 Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e kontratës, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit Kamion kiper, me peshë bartëse deri 5m3 1 cope Kamion, me peshë bartëse deri 3m3 1 cope Kamion me vinç, me peshë bartëse deri 8m3 1 cope Ne këtë aktivitet të prokurimit kanë aplikuar shtatë OE. Pesë prej tyre janë eliminuar ku ndër arsyet tjera ka qenë arsyetimin e mos përmbushjes se kriterit si më lartë. Eksperti shqyrtues gjatë administrimit të provave, dosja e tenderit, ofertat e OE në sistemin e e-prokurimit, njoftimin për vendim, kërkesën për rishqyrtim dhe përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim, Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Muharrem Hoti B.I." Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Muharrem Hoti B.I." janë pjesërisht të bazuara.LLP-ne, RRPP 001/2022, Ligjin L 02-70 për Sigurinë ne Komunikacion nuk ka gjetur dëshmi se ku është bazuar kriteri i kërkuar për m3 nga AK. Ne raportin e komisionit të vlerësimit eksperti shqyrtues ka vërejtur se komisioni i vlerësimit nuk e ka trajtuar apo përshkruar arsyetimin e detajuar se pse OE të janë eliminuar në bazë të mos përmbushjes se këtij kriteri. Sidoqoftë ne njoftimin mbi vendimin e AK-së te datës 28.12.2023 është përshkruar si arsye e eliminimit mos përmbushja e kërkesës dhe tejkalimi i peshës bartëse në m3 sipas Aneksit 8. Eksperti shqyrtues pas administrimit të provave si më lartë nuk ka mundur te gjejë në asnjë dokument të dorëzuar nga OE-të apo të përpiluar nga AK në këtë aktivitet të prokurimit se pesha bartëse e dhënë është shprehur në m3 prandaj vlerëson se arsyetimi i eliminimit të OE ankues për mos përmbushjen e peshës bartëse nuk është ne përputhje me dosjen e tenderit, aneksin 8, si dhe nenin 40.1, 40.2, 40.6 a), b) dhe 40.7 te RRPP 001/2022. Me qëllim të shqyrtimit te drejtë të pretendimeve Eksperti shqyrtues i drejtohet AK-se me email me kërkesën qe të më ofrohen sqarime për citoj" mënyrën e vlerësimit te këtij kriteri duke pas parasysh se kërkesa e peshës bartëse është bërë në m3 e ofertat janë dorëzuar për peshën bartëse ne kg. Qe te bëjë një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të lutem me ofron procesverbalin e vlerësimit të komisionit për mënyrën dhe formën e vlerësimit të këtij kriteri. AK-ja është përgjigjur: "Ne si AK: Komuna e Rahovecit, në Attachment po ju bashkëngjisim, Raportin e Vlerësimit te tenderëve, dhe Certifikatat e Regjistrimit te Automjeteve për Operatorin Ekonomik te Rekomanduar për Kontratë, ku ne baze

te dëshmive te ofruara nga Operatori Ekonomik, tek Libreza e Regjistrimit ceket: F1 - Pesha maksimale e ngarkesës së lejuar, ku nga kjo mund te vërehet se ne asnjë Librezë te Regjistrimit te Automjeteve nuk ceket m3 apo Kg" Eksperti shqyrtues prapë i ka dërguar email AK-së me kërkesën: "Dokumentet qe ju i keni bashkangjitur janë edhe në e prokurim. Në dosje të tenderit ju keni kërkuar që mjetet Kamion kiper, me peshë bartëse deri 5m3 1 cope Kamion, me peshë bartëse deri 3m3 1 cope Kamion me vinç, me peshë bartëse deri 8m3 1 cope "Pyetja ime është: Si është vlerësuar një OE nëse sipas jush ne asnjë libreze te qarkullimit nuk ka te dhëna as ne m3 as ne kg. Si e ka vlerësuar komisioni se një Operator është ne përputhje me kërkesën tuaj si me lartë". AK-ja nuk është përgjigjur në kërkesën e dërguar nga eksperti shqyrtues. Eksperti shqyrtues nga hulumtimet e bëra ka konstatuar se matja e peshës në m3 bëhet varësisht se çfarë produkti bartet duke llogaritur edhe peshën specifike të produktit në mënyrë qe të përllogaritet edhe hapësira ne m3 që mund të bartë e cila dallon nga lloji i produktit dhe pesha specifike. Për më tepër AK-ja ka dështuar të sqarojë se në çfarë mënyre ka bërë zbërthimin e kg në m3 në mënyrë që të arsyetojë vendimin. Gjatë kërkesës për sqarim AK deklaron se në asnjë librezë të dorëzuar nga operatori ekonomik nuk ceket m3 apo kg. Bazuar në përgjigjen e AK-së të gjitha librezat e dorëzuara nga OE -të e kanë përshkrimin e njëjtë prandaj asnjë dokument i dorëzuar nga OE-të nuk e përmbush kërkesën e AK-së. Prandaj duke pas parasysh edhe komunikimin eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ka dështuar që të bëjë vlerësimin në bazë të nenit 59 te LPP-se dhe ti trajtojë të gjithë OE-të sipas nenit 7 të LPP-së. Si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar. Sqarim për PSH: Duke pas parasysh ekspertizën dhe të gjeturat eksperti shqyrtues vlerëson se kthimi i aktivitetit të prokurimit ne rivlerësim ne këtë fazë duke pas parasysh kërkesën e Aneksit 8 dhe përgjigjen e AK-së është ne kundërshtim me nenin 1, 59 dhe 7 të LPP-së."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar sejanë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit andaj paneli shqyrtues vlerëson se aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, dhe eliminimit te Ankuesit për shkak të mos përmbushjes së Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa 3, paneli shqyrtues mbështet ekspertin shqyrtues dhe vlerëson se nuk janë gjetur dëshmi se ku është bazuar kriteri i kërkuar për m3 nga AK. Eshte gjetur se komisioni i vlerësimit nuk e ka trajtuar apo përshkruar arsyetimin e detajuar se pse OE të janë eliminuar në bazë të mos përmbushjes se këtij kriteri. Sidoqoftë ne njoftimin mbi vendimin e AK-së te datës 28.12.2023 është përshkruar si arsye e eliminimit mos përmbushja e kërkesës dhe tejkalimi i peshës bartëse në m3 sipas Aneksit 8.

Sipas ekspertit shqyrtues nuk është gjetur asnjë dokument i dorëzuar nga OE-të apo të përpiluar nga AK në këtë aktivitet të prokurimit se pesha bartëse e dhënë është shprehur në m3 prandaj arsyetimi i eliminimit të OE ankues për mos përmbushjen e peshës bartëse nuk është ne përputhje me dosjen e tenderit, aneksin 8, si dhe nenin 40.1, 40.2, 40.6 a), b) dhe 40.7 te RRPP 001/2022. Po ashtu, eksperti shqyrtues ka kërkuar 2 (dy) herë sqarime të detajuar rreth vlerësimit të bërë nga ana e komisionit të vlerësimit por ka pranuar vetëm herën e parë përgjigje duke i dërguar dokumentacion i cili gjendet në e-prokurim, ndërsa në emalin e dytë AK nuk është përgjigjur fare.

Bazuar në sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues i cili ka vlerësuar se matja e peshës në m3 bëhet varësisht se çfarë produkti bartet duke llogaritur edhe peshën specifike të produktit në mënyrë qe të përllogaritet edhe hapësira ne m3 që mund të bartë e cila dallon nga lloji i produktit dhe pesha specifike. Për më tepër AK-ja ka dështuar të sqarojë se në çfarë mënyre ka bërë zbërthimin e kg në m3 në mënyrë që të arsyetojë vendimin. Për me tepër gjatë sqarimeve të bëra nga ekspertit shqyrtues dhe autoriteti kontraktues, ky i fundit ka deklaruar se në asnjë librezë të dorëzuar nga operatori ekonomik nuk ceket m3 apo kg. Bazuar në përgjigjen e AK-së të gjitha librezat e dorëzuara nga OE -të e kanë përshkrimin e njëjtë prandaj asnjë dokument i dorëzuar nga OE-të nuk e përmbush kërkesën e AK-së.

Prandaj, në bazë të kësaj të cilën e ka evidetnuar eksperti shqyrtues paneli shqyrtues vlerëson se AK-ja ka dështuar që të bëjë vlerësimin në bazë të nenit 59 te LPP-se dhe ti trajtojë të gjithë OE-të sipas nenit 7 të LPP-së mirëpo nga të gjeturat e kësaj procedure të prokurimit e cila është në interes të nxënësve nëpër shkolla, paneli shqyrtues vlerëson qe mos ta përkrah rekomandimin e ekspertit shqyrtues për anulimin në tërësi të këtij aktiviteti të prokurimit, por lënda të kthehet në ri-vlerësim.

AK obligohet të bëjë vetëm ri-vlerësimin e atyre ofertave të cilat janë eleminuar për mos plotësim të vetëm këtij kriteri, duke përfshirë edhe ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Kështu që, në fazën e ri-vlerësim AK duhet të jetë objektiv të sqaroj mënyrën e vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave ta bëjë konform nenit 59 të LPP dhe gjithmon të respektoj nenin 7 të LPP. Nëse eventualisht ky kriter është i pamatshëm apo i pa arritshëm nga asnjëri OE, atëherë ta anuloj aktivitetin e prokurimit në tërësi.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos që mos ta anuloj këtë aktivitet të prokurimit por lëndën ta kthej në ri-vlerësim dhe AK të bëjë një vlerësim të gjendjes reale duke u bazuar të dispozita ligjore dhe të vije deri tek një vendim i drejtë dhe i paanshëm dhe nëse eventualisht nuk ka oferta të përgjegjshme atëherë të anuloj aktivitetin e prokurimit në tërësi. Komision i vlerësimit supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: "*Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës*". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit

të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- OE - **Avni Murtezi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: